

MELEQE KURSONI

HAMP-I PËR ORIGJINËN E SHQIPES E TË SHQIPTARËVE

Gjuha shqipe i takon grupit të gjuhëve indoevropiane, është në atë familje gjuhësh me burim të përbashkët, të cilat qysh në kohërat e hershme parahistorike janë folur në trevat që nga India në Evropë.

Më 1854 filologu gjerman Franc Bopp bëri të ditur origjinën e pastër indoevropiane të shqipes. Punën e Boppit e vazhdoi po ashtu një tjetër filolog gjerman, Gustav Meyer në vitet 1880-1890.

Stërhollime tjera linguistike për shqipen rreth origjinës së saj indoevropiane janë paraqitur edhe nga linguistët Holger Petersen dhe Norbert Jokl. Me çështjen e shqipes dhe vendndodhjen e hershme të shqiptarëve është marrë edhe linguisti amerikan Eric P. Hamp. Studimet e tij për historinë e gjuhës shqipe janë të shkrira me ato për etimologjitë, të shpërndara nëpër periodikun shkencor në gjithë botën. Duan veçuar trajtesat për vendin e formimit të shqipes, përgjithësisht për vendin e saj në kuadër të dialekteve indoevropiane, për raportet e saj me gjuhë që fshihen në errësira të kohës, ndihmesat thelbësore lidhur me laringalet indoevropiane në shqipen, saktësimet dhe kontributet lidhur me kronologjitë e ndryshimeve fonetike të shqipes dhe sqarimet e një numri jo të vogël etimologjish.

Tiparet arkaike që përfshijnë sistemin foljor, ruajtja e mbaresave të vetave të veçanta për vepronen dhe mesoren, ndryshimi i zanores *e* të së tashmes në *o* në kohën e shkuar, është veçori e përbashkët me gjuhët baltike. Për shembull folja *mbledh* (veprore) *mblidhem* (joveprore) të kohës së tashme, dhe *mblodha* me një *o* në kohën e shkuar.

“Shqipja nuk shfaq asnjë afri ngusht të veçantë me ndonjë nga gjuhët indoevropiane; ajo është plotësisht i vetmi i mbijetuar modern nga nëngrupi i saj.” (Hamp 2007:103)

Kategoritë gramatikore të shqipes janë të përafërta me ato të gjuhëve tjera evropiane. Emrat kanë gjini të dallueshme, numrin dhe rasën. Karakteristikë e pazakonshme është se për të treguar shquarsi apo pashquarsi emrat marrin mbaresat e shquarsisë p.sh. *bukë-buka*; Përveç numërorëve, disa shprehjeve kuantifikuese dhe emrave të varur, mbiemrat ndjekin emrin që ndryshojnë, janë të veçantë në kërkesën për një që i paraprin dhe që pajtohet me emrin. P.sh. *një burrë i madh*, *Burrë* ndryshohet nga *madh* dhe paraprihet nga *i* e cila pajtohet me termin *burrë*.

Gjatë ndërtimit të trajtave foljet janë mjaft të parregullta, kanë afërsisht numër dhe varietete të formave që kanë frëngjishtja apo italishtja.

Gramatika dhe veçoritë formale të shqipes afrohen me greqishten moderne, gjuhët romane dhe posaçërisht me rumanishten.

Përveç huazimeve tjera leksikore që shqipja ka me fqinjët e saj është me rëndësi të ndalemi te kontaktet e shqipes me greqishten e lashtë. Dëshmi e këtij kontakti është fjala geqe *mokën* (tosk. *mokër*) nga greqishtja *mekhane*. Gjithashtu edhe kontaktet e hershme me romakët kanë dhënë huazime të shumta latine. Do të veçojmë *mik* (shqip) nga *amicus* (latinisht) *këndoj* (shqip) nga *cantare* (lat.). Fjalë të tilla të huazuara në shqipe dëshmojnë për ngjashmëritë e zhvillimit të latinishtes së folur në Ballkan dhe të rumanishtes, një gjuhë romane të Ballkanit.

Rumanishtja me shqipen kanë të përbashkëta edhe disa terma indigjene, jolatine: p.sh. *breth* (shqip); *brad* (rumanisht). Të dyja këto gjuhë reflektojnë kontakte të veçanta historike të kohës së hershme.

Huazimet nga italishtja, turqishtja, greqishtja e re, serbishtja, sllavomaqedonishtja i atribuohen kontakteve kulturore të pesë shekujve të fundit me venedikasit, otomanët, grekët dhe sllavët.

Rreth çështjes së vendndodhjes së hershme të shqiptarëve, Hamp thotë se ka një përmbledhje të mirë dhe një varg referencash në librin e A. Rosetti, *Istoria limbii romine. II. Limbile belcanice*. Mirëpo sipas Hampit, Rosetti gabimisht përsërit mitin se disa dialekte toske shfaqin karakteristika geqe, duke sugjeruar një nënndarje më të vonshme dialektore. Në të gjitha dialektet që profesor Hamp ka studiuar izoglosa është e qartë, dhe përfshin pothuajse të gjitha tipet e mundshme. Kjo duhet të jetë relativisht e vjetër, daton nga periudha post-romake në mijëvjeçarin e parë. Ka mundësi që kjo izoglosë të reflektojë përhapje të atillë të arealit folës pas vendosjes së shqiptarëve, pikërisht në zonën ku janë tash, ashtu që areali folës të përfshinte zonën Jiriçek.

Edhe pse shumë studiues pajtohen se shqipes i mungon terminologjia e vjetër detare, D. Deçev-i mendon se shqipja e ka pasur por e ka humbur.

Mungesa e fjalorit të trashëguar nuk mund të dëshmojë asgjë. E. Çabej ka argumentuar për prani jo mjaft të vërejtur deri tash një numër të caktuar termash të vjetra detare. Mirëpo Hampit i duket se këto në pjesën më të madhe janë jokonkluzive në vetvete: *dēt* mund t'i referohet çdo uji të thellë; *vā*, *mat*, *vale* mund t'u referohen sasive të ndryshme të ujit. Fjalët si *grykë*, një metaforë e lehtë (throat-fyt); *ani* (*an(ë)*, *enë*) dhe disa emra të pjesëve të varkës (*ballë*, *pëlhurë*, *shul*, *lugatë* që shkon me fjalën *lugë*) po aq lehtë mund të kuptohen si metafora; *likurishtë* 'polip' dhe shumë emra të tjerë. Shpesh kompozita të dukshme janë përshkruese dhe supozohet të jenë ngritur gjatë përdorimit pothuajse në çdo kohë. Fjala *ngjalë* < **engella*, edhe nëse është e lidhur drejt me ilirishten *Εγγελάνας*, jo domosdoshmërisht presupozon detin. Prandaj, ende na mungon një korpus i dëshmuar i morfemave native të marinës pa lidhje të tjera morfologjike apo semantike në gjuhë që do të

mundësonin një transfer të tillë. Për një argument të tillë do të jenë bindëse vetëm format e izoluara. (Hamp 2007:117)

Për sa i takon emrit Shqiptar së pari është shfaqur në shek. XIV. Albi paraqitet më 1330 në një dokument anzhuin. Fisin Albanoi me qytetin Albanopolis, midis Orestis e Almopernit, diku në mes të Durrësit e Dibrës e përmend gjeografi Ptolomeu në hartën e tij botërore në shek. e II të e. re.

Enklavat e Italisë dhe të Greqisë përveç emrit të tyre tradicional përdorin edhe termin: arbresh; arbërishte. Profesor Hamp vë në pah dy grupe të vjetra huazimesh të shqipes të cilat na çojnë te një konkluzion i lehtë, por i vlefshëm. Që nga A. Thumb është pranuar se huazimet e greqishtes së vjetër në shqipen janë të rralla. Para shqipja vështirë të ketë pasur kontakte me greqishten në antikë dhe kjo i vendos shqiptarët në linjën Jiriçek.

Hampi thekson se Çabej kishte këmbëngulur se huazimet e greqishtes së lashtë nuk i zhvendosin parashqiptarët larg nga territori grek, përkundrazi ato përrputhen me vendndodhjen në Shqipërinë e sotme, në kontakt me kolonistët grekë dorikë ose me dorianët veriperëndimorë. Theksimi i karakterit të huazimeve dorike të shqyrtuara nga Çabej duket bindës: *drapën*, tosk. Drapër <* *δράλανον* më parë sesa *δρέπανον*; *kumbull* < *κοκκύμηλον*; *brukë* < *μυρική*; *trumzë* < *θύμβραα-θύμβρι*. Në forma paralele në enklavat greke të Italisë jugore paraqiten tri të fundit. Por sipas Hampit kjo ende nuk tregon se ku kanë qenë në kohën e kontaktit dorianët për të cilët po flitet.

Dëshmi mbështetëse, detaje relevante ka përditësuar dhe Bariç-i. Huazimet e vjetra gjermanike si: fat, shkum, tirq, nuk mund t'i vënë gjërat më afër gjeografikisht. Çështja mbetet skajshmërisht e pa sigurtë, sa më në veri dhe në lindje të kishin qenë shqiptarët, aq më të mëdha do të kishin qenë gjasat e tyre për kontaktet e asaj kohe me gotët.

Hampi thotë se W. Cimočovski i zhvendos shqiptarët shumë më pak se sa të tjerët te malet afër Matit, në veri deri te Nishi. Ndërsa Çabej duke u mbështetur në toponime, argumenton për një rajon bregdetar.

Cimočovski fillon duke shqyrtuar shkurt dhe në mënyrë kritike argumentet e Weigandit për prejardhjen trakase të shqipes dhe për një vendndodhje në lindje të vendndodhjes së tashme:

a) Toponimet me prejardhje latine në Shqipëri shfaqin zhvillime fonologjike të dalmatishtes dhe jo të shqipes.

b) Terminologjia e trashëguar e detarisë dhe e peshkimit mungon në shqipen. Këto fakte janë të kuptueshme lehtë, thotë Cimočovski, përderisa shqiptarët do të kenë vazhduar në zona më të thella, ku romanishtja nuk ka mundur të absorbonte tërësisht - së këndejmi jo në zona ku emra të tillë vendesh të origjinës latine kanë vazhduar të jetojnë më së fortë. Shqiptarët do të kenë jetuar më në brendësi nga zona bregdetare, në male por jo domosdoshmërisht larg kufirit të Shqipërisë.

c) Fjalë të caktuara, si *man*, janë të përbashkëta me trakishten (*μαντεία*). Por kjo në një farë mase mund të tregojë se ka pasur kontakte, kështu është e ditur se trako-frigasit *Βριγες* kanë jetuar afër Durrësit. Madje, Çabej mendon se edhe këto fjalë mund të dëshmojnë si të ilirishtes. Cimochovski shkon më tej duke theksuar se *karpë* dhe *mën* janë të përbashkëta në italishten e zonës para-romake; kështu që kjo korrespondencë e supozuar me trakishten është zhvendosur.

d) Emra të caktuar trakas supozohet se janë shpjeguar me ndihmën e shqipes. Nga këta, vetëm *Dacia Maluensis* (: *mal*) është shpjeguar në këtë mënyrë; *Dacebalus* (: *ballë*) dhe *Burebista* (*burrë* + *bisht*) sigurisht se janë gabim.

e) Toponimet shqipe të njohura që nga antika nuk shfaqin zhvillim fonologjik të shqipes. Kjo nuk duhet të jetë befasuese; që nga fundi i shekullit X, e gjithë Shqipëria jugore sundohej nga bullgarët. Mirëpo, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se nuk ka pasur shqiptarë askund në Shqipëri.

f) Huazimet e vjetra në rumanishten nga shqipja dhe zhvillimet e përbashkëta shqiptaro-rumune nga latinishtja indikojnë një prejardhje lindore. Mirëpo, shprehjet nomade të vllëve dhe kultura baritore e shqiptarëve do t'i kenë sjellë ata në kontakt për periudha ndoshta të gjata në të kaluarën. Madje, duke theksuar se shqiptarët mund të kenë pasur edhe kontakte lindore, ne ende nuk e dimë se ku ka qenë kufiri iliro-trakas, ndërsa *Ναῖσος* (*Nish*) nga shumica konsiderohet si territor ilir. (Hamp 2007:122-123)

Sipas këtyre shqyrtimeve Hampi vë në dukje se Cimochovski nxjerr përfundimin se vetëm jugu i Shqipërisë, veriu përreth Shkodrës dhe bregdeti i Adriatikut janë përjashtuar si territore të hershme shqiptare. Kjo nuk dëshmon lidhjen me trakishten. Cimochovski dhe Stadmüller arrijnë në përfundimin se atdheu i shqiptarëve ishte diku në fqinjësi të Matit, duke u zgjeruar deri te Nishi.

Në mënyrë bindëse Çabej argumenton tezën se shqiptarët kanë vazhduar të banojnë aty ku kanë banuar më parë dhe ilirët, duke u mbështetur në studimet e shumë studiuesve sikurse janë: Thunman, Hahn, Kretscmer, Ribezzo, La Piana, Shufflay dhe Erdeljanoviç. Sipas pikëpamjes Jiriček ilirët e gjysmëromanizuar u larguan në jug në malet ndërmjet Dalmacisë dhe Danubit. Studiues tjerë si Paravan, Puscariu dhe Capidan thonë: Në shekujt III dhe IV si nomadë ata lëvizën nga jugu i Karpateve. Të ardhur nga Panonia i bien Procpovici dhe Philippide. Wegand-i i vendos shqiptarët dhe rumunët në territorin trakas ndërmjet Nishit, Sofjes dhe Shkupit. Ndërsa për Joklin, Duhamin dhe Skokun shqiptarët ishin në Dardani, ku takoheshin Iliria dhe Trakia, ata lëvizën në Shqipëri në periudhën e vonshme romake, kështu sllavët i takuan ata në basenin e Bunës. Sipas Bariçit ata nga Ballkani dhe malet Rodope lëvizën në Shqipëri para sllavëve. Stadtmüller thekson: ata ishin në basenin e Matit në Shqipërinë Veriore dhe drejt jugut lëvizën në Mesjetë. Supozimi i Stadtmüller-it sipas Çabejt është tepër i kufizuar.

Duke paraqitur argumentet e Çabejt, Hamp vazhdon: Emrat e lumenjve dhe qyteteve janë më jetëgjata se një gjuhë, mendon Çabej, përderisa ato të fshatrave në Ballkan përgjithësisht janë të vonshme dhe të lëvizshme. Shumë emra të dëshmuar nga burimet antike ndjekin zhvillimet fonologjike të shqipes si: *Scardus* > *Shar*; *Scodra* > *Shkodër*. Çabej vëren se *sk-* > *h-* i takonte periudhës parabalkanike dhe e krahasonte me fonologji; *shkamb* < *scamnum* dhe *këlshedër* < *chersydrus*. *Barbana* > *Buenë* është e rregullt, tregohet edhe nga Jokl-i. *Lissus* > *Lesh*, *missa* > *meshë*. Sipas Çabejt latinishtja *ī* + *CC* është e rregullt, profesor Hamp tani për tani nuk mund ta pohojë por as ta mohojë. *Dyrracium* > *Durrës*, *Issamnus* > *Ishm*, *Drivastum* > *Drisht* indikojnë për një theks nistor të ilirishtes. Dukuri e rregullt në dialektet qendrore të shqipes është edhe *Shkum(b)i* < *Scampinus* ku *ë* paratheksore > *u* dhe *mb* > *m* janë të pritura. *Thyamis* > *Çamëria*, e vërejtur nga Leake më 1814 e pranuar dhe nga Çabej. *Arachthos* > *Artasupozohet* se shpjegohet më mirë për mes shqipes se sa greqishtes. Mirëpo vëren Hamp, përveç sinkopës befasuese, *kt* duhet të derivojë *ft* ose *jt* dhe jo *t* nga ajo kohë. Gjithashtu *Ragusium* (*Ragusa*) te Bogdani është *Rush*.

Sipas Çabejt bregdeti mbeti shqiptar që nga lashtësia. Emrat e huaj paraqesin shtresa të ndërhyrjeve të mëvonshme të cilat Weigand-i nuk i kishte vërejtur dhe i kishte trajtuar në mënyrë të padiskriminueshme.

Sipas Hamp-it qëndrimi i paraqitur nga Bariç është më i besueshëm dhe i mbështetur nga puna e kujdesshme që Skok bëri lidhur me toponimet e Ballkanit në raport me gjuhët romane. Bariç zhvillimin e **kt* > *t* e shikon sitë përbashkët në mes shqipes dhe rumanishtes. Bariç shfrytëzon simbiozën e njohur me pararumunët dhe emrat e vendeve *Nish*, *Shkup* dhe *Shtip*, ai shqiptarët i vendos në rajonin e Dardanisë-Peonisë.

Lidhur me çështjen se ku kanë qenë shqiptarët në kohën kur mbërritën sllavët ka mendime të ndryshme. Sipas Selishçev-it sllavët në Shqipëri takuan vetëm romanët. Selishçev ka treguar qartë se shumica e territorit shqiptar në mesjetë u ishte ekspozuar sllavëve, dhe vetëm rajoni qendror ka toponime sllave, çka ndoshta e thekson përqendrimin e hershëm të shqiptarëve atje. Përderisa Bariç-i pas Jokl-it, bjerren e C-së së zëshme ndërzanore në shqipen e konsideron si passllave.

Kjo do të shpjegonte *Shkinikë* “*Bullgari*” < *Sllavnica*; etimoni rishfaqet qartë në enklavat greke si *škrehište* ‘në një gjuhë tjetër (greke)’. Mirëpo, kjo po ashtu mund të ketë pasur etimon latin. Labëria në jug ka *-r*-tosk. nga *-n*-ndërzanore dhe *la* të metatizuar të sllavishtes, mirëpo ne mund të vëmë edhe radhë tjetër për paraqitjen e tyre. Skok ka *Durrës*<*Durrachium* (por, do thënë se kërkohet **/dú/!*)

Paraserbishtja do të ketë theksuar *Drač* në rrokjen e dytë. Cimočovski vendos *Δυρρακίων* {*dur:akhijon*}, e marrë në ilirishte si *dúrrakj-u*-(*pas*o>a*) > **dúrrac 9An*> **S*;

Kjo e zgjeron dhe e mpreh më tej trajtimin e mësipërm të Çabejt lidhur me këta emra. (Hamp 2007:126)

Nga të gjitha dëshmitë të cilat u paraqitën, Hamp nuk mund të pranojë si të tërë asnjërën nga zgjidhjet e sipër përmendura, por ai gjithashtu nuk mund të refuzojë asnjërën prej këtyre zgjidhjeve si krejtësisht të gabueshme.

Sipas Hamp-it një përmirësim i paraqitjes së Bariç-it lidhur me emrin e lumit Buna do të mund të bëhej vetëm nëse vendosim një formë* *barrbana* (shënohet se *Berat* e ka humbur –g- e tij sllave) = /*baruanna*/ > **borjan(n)a* (përmes përshtatjes sllave) > **bojana* (në shqipen e hershme; *ujë*<**udrjā*), nga *Barbanna* të Livy-t. Atëherë këtu do të mund t'i kishim të gjitha ndryshimet e shpjeguara nga rregullat e njohura, por jo edhe një kronologji të qartë.

“Natyrshisht në çdo situatë ne mund të dëshmojmë se vetëm shqiptarët kanë qenë (aty) para sllavëve dhe kurrë se nuk kanë qenë sllavët para tyre.”(Hamp2007:126)

Në konferencën e organizuar më 18 dhjetor 2008 nga QSA albanologu amerikan, Eric P. Hamp deklaroi se: “Tani mund ta besojmë historinë e gjuhës në lidhje me ilirishten, duke e vendosur atë në aspektin indoevropian, në kuadër të grupit veriperëndimor”.

Kjo deklaratë e shoqëruar për herë të parë dhe me etimologjinë e disa fjalëve krahasuese, si etimologjia e fjalës *thika*- gjendet te fjala e latinishtes *siko*, po ashtu fjala *thupra*- është krahasuar me fjalën latine *sibina*.

Në natyrën e punës së tij profesor Hamp ka mendimin që është vazhdimisht në zhvillim. Edhe pse i munduar nga pleqëria, por jo nga fenomeni i një albanologu që për gjysmëshekulli nuk rresht së nxjerri fjalë krahasuese nga ilirishtja që e qojnë në bllokun e gjuhëve të vjetra ilire, ku hyn edhe mesapishtja. Kjo është teza e tij, që siç duket bashkë me jetën e këtij albanisti amerikan, do mbyllë edhe kapitullin e debateve mbi shqipen.

Përfundim

Duke u bazuar nga shqyrtimet e përmbledhura në këtë punim, mund të konkludojmë se emrat topike të Shqipërisë të cilat njihen që nga kohërat antike e këtej, së bashku me terminologjinë detare të shqipes, e me huazimet dorike- greke veriperëndimore që ruhen në këtë gjuhë, dëshmojnë autoktoninë e shqiptarëve në viset bregdetare të Adriatikut, së paku që prej kohës greko-romake, në atdheun Ballkanik të shqiptarëve.

Edhe në qoftë se nga pushtuesit e huaj u shty duke u tërhequr për disa kohë në zonat malore, ky element etnik nuk u largua asnjëherë nga horizonti i Adriatikut, sikurse vërteton një varg emrash topike të lashta, e gjithashtu edhe karakteri arkaik i huazimeve latine.

Dardania dhe Shqipëria veriore, bashkë me krahinën e Matit duhet të shikohen si pjesë të trevës gjuhësore të kryehershme.

Hamp-i për origjinën e shqipes e të shqiptarëve

Shqipja është formuar në përgjithësi në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pasur ndonjë ndryshim gjatë kohëve.

BIBLIOGRAFI

- “Gazeta standard”, 19 dhjetor 2008, *Albanologu amerikani: Tani e besojmë ilirishten*.
Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1976/
Eric Hamp, *Studime krahasuese për shqipen*, ASHAK, Botime të veçanta LXXXIII, Seksioni i Gjuhësisë dhe i letërsisë, libri 37.
Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

